



KUVENDI KOMUNAL PRISHTINE * MUNICIPALIT ASSEMBLY PRISHTINA * SKUPSTINA OPSTINA PRISTINA

Në bazë të nenit 3, par.1, pika b të Rregullores mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës nr. 2000/45, të dt. 11 gusht 2000, të nenit 19, par.1, pika b dhe të nenit 40, par.3, pika II të Statutit dhe Rregullave të procedurës të Komunës së Prishtinës, të dt. 16.3.2001, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 31.08.2006, merr

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E PLANIT PËR VENDOSJEN E QOSHQEVE NË QYTETIN E PRISHTINËS

Neni 1

Miratohet Vendimi i Planit për vendosjen e qoshqeve në qytetin e Prishtinës.

Plani, nga paragrafi 1 i këtij neni, përmban pjesën tekstuale dhe grafike, të cilat paraqesin pjesë përbërëse të këtij Vendimi.

Neni 2

Plani për vendosjen e qoshqeve, i miratuar me këtë Vendim, është hartuar nga Drejtorati i Planifikimit, Urbanizmit dhe i Ndërtimtarisë i Komunës së Prishtinës, si detyrë e caktuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës nr. 01-110-24896, të dt. 28.10.2005.

Neni 3

Vendosja e qoshqeve në lokacionet e planifikuara sipas planit të miratuar me këtë Vendim, do të kenë karakterin e përkohshëm.

Në lokacionet e planifikuara sipas planit të miratuar me këtë Vendim, do të lejohet vendosja e qoshqeve sipas zgjidhjes arkitektonike të kësaj kategorie të objekteve të përkohshme, sipas konkursit të shpallur e të zgjedhur, të miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

Neni 4

Plani i miratuar me këtë Vendim paraqet fazën e parë të hartimit të planit për vendosjen e qoshqeve, në pajtim me nenin 3 të Vendimit për hartimin e planit për vendosjen e qoshqeve në qytetin e Prishtinës nr-01-110-24896, të dt. 28.10.2005.

Neni 5

Leja për vendosjen e qoshqeve në lokacionet e planifikuara në planin e miratuar me këtë Vendim, lëshohet nga Drejtorati i Planifikimit, Urbanizmit dhe i Ndërtimtarisë.

Neni 6

Mënyra dhe procedurat e dhënies në shfrytëzim të lokacioneve të planifikuara me planin e miratuar me këtë Vendim, do të bëhet sipas procedurave të parapara ligjore.

Neni 7

Për realizimin e këtij Vendimi do të kujdeset Bordi i drejtorëve i Komunës së Prishtinës.

Neni 8

Ky Vendim hyn në fuqi dhe zbatohet nga dita e miratimit të tij në Kuvendin e Komunës së Prishtinës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01.Nr.35-435, më 31.08.2006

KRYETARI I KUVENDIT
Ismet Beqiri

LOKACIONET PËR VENDOSJEN E QOSHQEVE

- Rruga “Nënë Tereza”, përballë hotelit “Iliria” (para librariesë).....2
- Këndi i rr. “Nënë Tereza” dhe rr. “Qamil Hoxha”.....1
- Rruga “Nënë Tereza”, përballë hotelit “Grand”.....2
- Rruga “Nënë Tereza” përballë “Radio Prishtinës.....2
- Rruga “Luan Haradinaj” – parkingu “Ardi”.....2
- Rruga “Luan Haradinaj” – afër OSBE-së.....1
- Përgjatë rr. “Agim Ramadani”.....4
- Rruga “Fehmi Lladrovci” 1
- Rruga “Bulevardi Bill Klintoni.....2
- Rruga “Enver Maloku”.....2
- Rruga “1 Tetori”.....2